



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**V E N D I M**

**Nr. 59, Datë 13/04/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 48, datë 30.03.2021, e z. A.H., ku pretendohet diskriminim i babait të tij, z. P. Gj., për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, nga ana e KMCAP Epror.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se babai i ankuesit A.H., prej dy vitesh është i sëmurë dhe i diagnostikuar me AVC të përsëritur. Si pasojë e sëmundjes, ai është i paralizuar dhe nuk kryen asnjë funksion jetësor minimal për t’u kujdesur për veten. Mjekët neurologë të Spitalit të Shkodrës e kanë drejtuar z. P.Gj. për tek KMCAP e Nivelit të Parë Shkodër. Me Vendimin nr. 3743, datë 09.01.2021, të KMCAP së Nivelit të Parë/Rajonal, z. P.Gj. është diagnostikuar me AVC-ishemik i përsëritur dhe është deklaruar përfitues i statusit të para-tetraplegjisë, grupi i parë, prej datës 01.02.2021, deri më 01.02.2022. Në fund të vendimit të sipërcituar është shënuar: “*Divergjencë, të vlerësohet në KMCAP Epror*”. Pas kryerjes së vlerësimit përkatës, me Vendimin nr. 110, datë 25.02.2021, të KMCAP Epror, është vendosur se z. P.Gj. nuk përfiton pagesë për aftësinë e kufizuar, si dhe përfitimet e tjera të vendosura me Vendimin nr.3743, datë 09.01.2021, të KMCAP të Nivelit të Parë.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në këto kushte, djali i P. Gj. pretendon se babai i tij diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e KMCAP Epror dhe kërkon ndërhyrjen e KMD-së për hetuar ankesën e tij dhe për të bërë të mundur ri-shqyrtimin e dosjes së babait të tij nga KMCAP Epror. Ankuesi thekson faktin se nuk i përballon dot shpenzimet mjekësore të babait të tij, pasi nuk ka të ardhura të mjaftueshme dhe i duhet të mbajë familjen e tij.

## **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

### **A. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 48, datë 30.03.2021, e z. A.H., KMD konstatoi se:**

Në ankesën nr. 48, datë 30.03.2021, e z. A.H., pretendohet diskriminim i babait të tij, z. P.Gj., për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, nga ana e KMCAP Epror. Nga analizimi ankesës së depozituar rezulton se babai i ankuesit, z. P.Gj. është diagnostikuar me AVC të përsëritura, THA dhe Cardiopati (operuar në vitin 2002, në Itali). Referuar aktit *“Fletë Drejtimi për KMCAP”*, lëshuar nga Spitali Neurologjik, Shkodër në datën 30.10.2020, rezulton se z. P.Gj. ka lodhje trupore, pamundësi për të lëvizur nga krevati, pamundësi për të komunikuar, pamundësi për të shërbyer vetes, nuk kontrollon sfinkteret dhe nuk ka orientim.

Me Vendimin nr. 3743, datë 09.01.2021, të KMCAP të Nivelit të Parë, z. P.Gj. është diagnostikuar me AVC-ishemik i përsëritur dhe është deklaruar përfitues i statusit të paratetraplegjisë, grupi i parë, prej datës 01.02.2021 deri më 01.02.2022. Njëkohësisht, sipas vendimit të sipërcituar, është vendosur që z. P.Gj. ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, si dhe ka nevojë për një paketë të veçantë higjieno-sanitare, sipas VKM-së nr. 78, datë 07.02.2007, *“Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”*, të ndryshuar. Në fund të vendimit të sipërcituar është vënë shënimi *“Divergjencë, të vlerësohet në KMCAP Epror”*. Pas kryerjes së vlerësimit përkatës, KMCAP Epror ka vendosur nëpërmjet Vendimit nr. 110, datë 25.02.2021, se z. P.Gj. nuk përfiton pagesë për paaftësi të kufizuar, si dhe përfitimet e tjera të vendosura me Vendimin nr. 3743, datë 09.01.2021, e KMCAP të Nivelit të Parë.

Në këto kushte, ankuesi pretendon se babai i tij diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar nga KMCAP Epror.

### **Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:**

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të

shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 20, pikat 1 dhe 2, gërma c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:.....2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:.....c) Kontributin dhe mundësinë për të përfutuar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 8/a, e ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” parashikohet shprehimisht: “Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë: a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshë;....”

Pikat 1 dhe 2, të nenit 18, të ligjit të sipërcituar parashikojnë se:“Përfitimi i pagesës nga personat me aftësi të kufizuar bëhet në bazë të vendimit të komisioneve të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji, të cilat vlerësojnë aftësitë e kufizuara sipas kompetencës së tyre. Kriteret, procedura

dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. Pagesa e personave me aftësi të kufizuar shpërndahet një herë në muaj nga bashkia, nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vërtetimin për vendimin e marrë nga komisioni që ka kryer vlerësimin e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve për çdo kategori të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.”

Në nenin 29, të këtij ligji parashikohet procedura e ankimit, që çdo individ me aftësi të kufizuar mund të ndjekë, kur gjykon se i është shkelur një e drejtë e garantuar nga ky ligj. Neni 29 parashikon: “1. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuar, kur gjykon se i është shkelur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës. 2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. 3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës. **4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.**”

Pika 3, e Vendimit nr. 182, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal” parashikon se: “Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, bëhet nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) të nivelit të parë, të Shërbimit Social Shtetëror.” Në pikën II/1, të këtij Vendimi përcaktohet se: “Pranë Shërbimit Social Shtetëror do të ngrihen dhe do të funksionojnë 5 (pesë) KMCAP-e të nivelit të parë, që do të vlerësojnë në nivel kombëtar dosjet e personave të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me këtë përbërje: ..... c) 1 (një) KMCAP për paraplegjinë, tetraplegjinë dhe neurologjinë, që do të ketë në përbërje neurolog; .....”.

Në pikat 9/a dhe 11 të Vendimit nr.707, datë 9.9.2020, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara,si dhe të ndihmësit personal” parashikohet shprehimisht se: “ 9.

*KMCAP-ja eprore ka këto detyra: a) shqyrton dhe zgjidh kërkesat e personave me aftësi të kufizuara, që ankimojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve vendimet e KMCAP-ve të nivelit të parë, si edhe shqyrton dhe zgjidh rastet e dërguara me divergjencë nga KMCAP-ja e nivelit të parë”;* “11. Në rastet kur ndërmjet anëtarëve të komisionit ka mendime të ndryshme, vendimi merret me divergjencë dhe anëtari që nuk është dakord me të tjerët argumenton vendimin me arsyet e divergjencës. Në këto raste, vendimi nuk ka fuqi ligjore ekzekutive dhe së bashku me dosjen dërgohet zyrtarisht në KMCAP-në eprore të specializuar.” Në rastin konkret, Vendimi i marrë nga KMCAP Rajonal për z. P.Gj. është dërguar me divergjencë<sup>3</sup> për shqyrtim e vlerësim në KMCAP Epror.

Referuar pikës 13, të VKM-së së sipërcituar rezulton se vendimi i KMCAP-së eprore të specializuar nuk mund të ndryshohet nga KMCAP-ja e nivelit të parë. Në ato raste kur KMCAP-ja e nivelit të parë gjykon se kërkuesi paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për të ndryshuar kushtet e përfitimit, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e këtij ndryshimi. Në këto raste, pavarësisht vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë, vendimi do të hyjë në fuqi vetëm pas miratimit të KMCAP-së eprore të specializuar. Sipas aktit nënligjor të sipërcituar, vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë.

Në rastin konkret, KMCAP i Nivelit të Parë ka kërkuar vlerësimin e vendimit të tij, që është marrë me divergjencë, nga ana e KMCAP Epror. Ky i fundit ka marrë vendim të formës së prerë që z. P.Gj. nuk mund të jetë përfitues i pagesës për aftësi të kufizuar, për shërbimin e kujdestarisë etj. Për analogji të neneve të sipërcituar, në rastin konkret vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë dhe si i tillë mund të ankimohet vetëm gjyqësisht.

Në këtë kontekst, Komisioneri sqaron se rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtij organi nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.<sup>4</sup>

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, gërma b), të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet nëse: ...b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, Komisioneri gjykon se ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

---

<sup>3</sup> Vendim i marrë me divergjencë është ai kur anëtarët e KMCAP Rajonal kanë shprehur mendime të ndryshme lidhur me rastin në shqyrtim.

<sup>4</sup> Për analogji citojmë: Vendimin nr.185, datë 28.09.2018, Vendimin nr.55, datë 24.04.2019 dhe Vendimin nr.06, datë 08.01.2020 dhe Vendimin nr. 61, datë 12.06.2020, e KMD, publikuar në web-in e institucionit: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që bazuar në Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, ankuesi t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të kundërshtuar vendimin e KMCAP Epror.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon gjithashtu subjektit ankues, që t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike<sup>5</sup>, ose Shërbimit Ligjor Falas<sup>6</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 7, nenin 20, pikat 1 e 2, gërma c), nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma b), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 48, datë 30.03.2021, së z. A.H., pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Të mira dhe shërbime  
Shkak – aftësi e kufizuar  
Lloji vendimit - mospranim

---

<sup>5</sup> Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

<sup>6</sup> Me adresë: Blv. “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.